

## ISP: KOMENTE DHE REKOMANDIME MBI RAPORTIN VJETOR 2025 TË SPAK

*Instituti i Studimeve Politike (ISP), në kuadër të misionit të tij për monitorimin e institucioneve të pavarura dhe promovimin e standardeve të larta të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit publik, mbështetur nga NED, ka analizuar Raportin Vjetor 2025 të SPAK dhe paraqet në vijim një vlerësim të përgjithshëm si dhe rekomandime konkrete për shqyrtim parlamentar.*

### I. Vlerësim i përgjithshëm

Raporti vjetor i SPAK ofron një pasqyrë të gjerë të aktivitetit institucional, duke evidentuar rritjen e volumit të hetimeve, përfshirjen në çështje me profil të lartë dhe konsolidimin gradual të rolit të institucionit në sistemin e drejtësisë. Me të drejtë SPAK vijon të jetë institucioni shqiptar më me mbështetje publike, si dhe me ndikim të madh edhe në përpjekjet drejt një sistemi më llogaridhënës sidomos në aspektin e antikorrupsionit dhe dhënies së drejtësisë. Në këtë kuptim, në tërësinë e tij raport konfirmon këtë vlerësim e pritshmëri.

Megjithatë, bazuar në një vlerësim më strategjik mbi cilësinë e informacionit që paraqet, ne mendojmë se raporti mbetet kryesisht i orientuar drejt të dhënave statistikore dhe përshkrimeve të përgjithshme. Atij i mungon një analizë më e thelluar dhe profesionale mbi impaktin në dhënien e drejtësisë dhe aktivitetin kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbi cilësinë e hetimeve, efektivitetin e vendimmarrjes dhe disa sfidave prioritare që lidhen specifikisht me zhvillimet 2025. Duke sugjeruar që Kuvendi të rishikojnë metodologjinë e raporteve vjetore, për ti bërë ato sa informuese aq edhe me efekt referimi dhe qasje strategjike ndaj sfidave të ardhshme, nxisim edhe idenë që vetë SPAK të aplikojë në të ardhmen një format të tillë më analitik dhe të orientuar drejt rezultateve.

### II. Rekomandime kryesore

#### 1. Transparenca dhe llogaridhënia publike

Raporti adreson që në krye të tij shqetësimin mbi retorikën politike e publike ndaj SPAK, por për ISP kjo nuk duhet të marrë rëndësi të tillë dhe as të jetë vëzhgim prioritar. Në thelbin e SPAK janë hetimet ndaj korrupsionit në nivele të larta dhe krimit të organizuar, ndaj është e pritshme që kategori të tilla të jenë reaguese, kritike dhe penguese ndaj hetimeve. E kundërta do të ishte shqetësim. SPAK nuk është krijuar për të edukuar politikën dhe publikun, krimin e organizuar apo subjektet e tjera nën hetim, por për të ofruar drejtësi, dhënie fund të pandëshkueshmërisë dhe forcim të shtetit të së drejtës. Nëse kjo arrihet zgjidhet edhe çështja e sjelljes politike dhe publike ndaj Kushtetutës, ligjit, integritetit, SPAK dhe institucioneve të së drejtës.

Ne mendojmë se shqetësimi kryesor duhet të jetë korrupsioni i nivelit të lartë ende i përhapur, ndikimi i SPAK në funksionalitetin e shtetit të drejtës dhe demokracisë, si dhe përmbushja e pritshmërive publike për integritet politik. Sugjerimi ynë është që SPAK të forcojë komponentin e transparencës duke rekomanduar publikimi i analizave mbi performancën reale; komunikim më ndëraktiv me publikun, rritje e aksesit në të dhëna dhe rezultate konkrete, forcimi i dialogut me shoqërinë civile dhe ekspertët e fushës, integrimi dhe trajtimi i gjetjeve të aktorëve të tjerë monitorues dhe ndërtimi i mekanizmave më efektivë për llogaridhënie.

ISP vlerëson gjithashtu shqetësimi i ngritur nga raporti, - nismat ligjore ose nënligjore që mund të kenë ndikim në aktivitetin e SPAK, duhet të marrin më shumë vëmendje e prioritet, shumë më tepër sesa debati rreth mandatit dhe karriera e ardhshme e prokurorëve të SPAK. Identifikimi i boshllëqet ligjore duhet të shoqërohet me propozime konkrete për ndërhyrje, si dhe garanci se në çdo rast fokus është avancimi profesional dhe institucional i reformës në drejtësi.

Pjesë e vlerësimit duhet të ishte edhe përgjigjia ndaj ndryshimit të mekanizmit të raportimit vjetor 2026 në Kuvendin e Shqipërisë (element që mungon), si dhe një vlerësim mbi një sistem më efektiv raportimi duke sugjeruar reduktimin e raporteve paralele vjetore (në KLP, Komisionin e posaçëm parlamentar, Këshillin e Integritit, Komisionin e Ligjeve, dhe në fund edhe seancën plenare), si dhe kalimi në aplikimin e nismave për raportimeve të dedikuara mbi tematika specifike që kërkojnë e marrin zgjidhje në parlament.

## 2. Mbështetja për ngritjen e një njësie të avancuar kërkimore dhe analitike

Rekomandohet krijimi dhe forcimi i një njësie të brendshme profesionale që të analizojë cilësinë e hetimeve dhe vendimmarrjes, trendet e korrupsionit VIP dhe krimin të organizuar, impaktin institucional të çështjeve të trajtuara, raportet funksionale dhe institucionale midis SPAK e KPK, SPAK dhe PP, SPAK dhe GJKKO, etj, për të ofruar informacion më cilësor mbi funksionalitetin e sistemit dhe të vetë reformës dhjetë vjet pas nisjes së saj.

Këto sugjerime ndërlidhen me nevojën për mekanizma më cilësorë të rivlerësimit (vetingu në vijimësi), duke siguruar zhvillimin e një sistemi më profesional dhe të qëndrueshëm vlerësimi, fokus në cilësinë dhe integritetin, si dhe përmirësim i standardeve të proceseve ekzistuese bazuar edhe në vendimmarrjet e GJEDNJ.

## 3. Hetime më të thelluara për krimet zgjedhore

Shoqëria civile ka pasur pritshmëri më të larta për aktivitetin e SPAK lidhur me hetimin e krimeve zgjedhore 2025, si dhe në mënyrë kritike konstatuam se ky element ka marrë vend simbolik në raportin vjetor. Duke i njohur kufizimet ligjore dhe administrative dhe kompleksitetin e hetimeve të tilla, SPAK mund të kishte një qasje më proaktive, jo vetëm në vlerësimin e bilancit lidhur me hetimin e krimeve zgjedhore, por edhe në adresimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve përmirësuese për të ardhmen. Në një vend ku vihet në dyshim standardi zgjedhor dhe ku zgjedhjet shihen edhe si produkte të nivelit të lartë akuzues e korruptiv të aktorëve të përfshirë, SPAK mendojmë se duhet të ishte më aktiv, më reflektues, dhe më strategjik.

Thelbi i hetimit të krimeve zgjedhore nuk janë procedurat e denoncimeve nga Policia e Shtetit apo aktorët politikë, por hetimi i thelluar mbi rastet më flagrante, duke i bërë ato shembull të drejtësisë shteruese, pavarësisht nëse në to përfshihen zyrtarë të lartë, kryetarë partish, deputetë apo zyrtarë të barasvlershëm me ta.

Për 2026 sugjerojmë që krahas forcimit të hetimeve proaktive për krimet zgjedhore, si dhe analizimi i rrjeteve të ndikimit në procese zgjedhore të ushtrohet edhe raportim periodik tematik mbi këtë fenomen në Kuvend dhe një bilanc i memorandumit midis SPAK, KQZ e PP.

#### 4. Lidhur me proceset dhe çështjet VIP

Besimi i lartë publik te SPAK dhe bilanci statistikor lidhur me hetimet VIP, sidomos për rastin e zyrtarëve të lartë, ndërthuren duke përbërë një prej aspekteve të identifikueshme të suksesit të reformës në drejtësi dhe progresit të vendit. Gjithsesi, ne vlerësojmë se mundësitë janë më të mëdha, për t'iu dhënë përgjigje disa shqetësimeve si p.sh., përse proceset hetimore marrin kaq shumë kohë, përse hetimet bazohen kryesisht mbi zyrtarët e larguar nga funksionet zyrtare, përse masa penale nuk shoqërohet menjëherë me kalimin në gjykatë për gjykim dhe përse procese të njëjta hetimore dhe gjyqësore ku përfshirën subjekte të huaja, në vendet e tjera zgjasin shumëfish më pak kohë sesa në Shqipëri.

Aspekti i dytë i ndërlidhur ka të bëjë me sekuestrimin / konfiskimit të pasurive të zyrtarëve të lartë të përfshirë në akte korruptuese. Të dhënat e raportit për vlerën e financiare të siguruar në këto raste janë jashtëzakonisht të vogla në raport me pasurinë reale të tyre, shifrat financiare për të cilat akuzohen dhe raportet/perceptimin e gjerë publik mbi pasurinë e krijuar nga zyrtarë dhe ish zyrtarë të korruptuar. Për këtë rekomandohet rritje e efikasitetit në konfiskimet përfundimtare; fokus në pasuritë e zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion, si dhe përmirësim i mekanizmave të rikuperimit të aseteve.

#### 5. Parandalimi i konfliktit të interesit në shqyrtimin parlamentar

Në funksion të garantimit të integritetit të procesit parlamentar, ISP rekomandon që Kuvendi të marrë masa për shmangien e konfliktit të interesit gjatë shqyrtimit të raportit të SPAK. Në veçanti, deputetët që janë subjekt i hetimeve nga SPAK të mos marrin pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e raportit; të aplikohen standarde të qarta vetë-përrjashtimi, si dhe të rritet roli i ekspertizës së pavarur dhe i dëgjësive publike. Këto masa do të forconin besimin publik dhe integritetin e mbikëqyrjes parlamentare.

Kuvendi ka rol thelbësor në garantimin e këtyre standardeve përmes mbikëqyrjes efektive dhe mbështetjes institucionale.